

Titulli i lëndës: HISTORIA OSMANE E BALLKANIT

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Historia osmane e Ballkanit
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i III-të, Semestri i V-të
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Departamenti i Ballkanistikës Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. asst. dr.
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	Sundimi osman disa shekullorë në Ballkan ka lënë gjurmë të thella në kulturën, gjuhën, jetën shoqërore, demografinë, religjionin, arkitekturën, artin, letërsinë dhe në aspektet tjera të jetës shoqërore të popujve të Ballkanit. Për të kuptuar shumë aspekte të gjuhëve, kulturës, artit dhe letërsisë së popujve të Ballkanit, duhet pasur parasysh ndikimit, kontaktet dhe marrëdhëniet e këtyre popujve që një periudhë kanë qenë nën sundimin e Perandorisë osmane, posaçërisht pas vitit 1453, kur Stambolli është bërë kryeqendër e Shteti osman, deri në fillimin e luftërave ballkanike në fillim të shekullit XX.

Qëllimet e lëndës:

Lënda ka për qëllim të ofrojë një pasqyre të aspekteve të ndryshme historike të periudhës ndërmjet shekujve XV-XX. Në këtë lëndë do të ofrohen informata për organizimin shtetëror në Ballkan të Perandorisë osmane, për ekonominë, strukturën demografike, për fenomenin e islamizimit dhe trashëgiminë kulturore, për shkollimin e popujve të besimit islam dhe për lëvizjet kombëtare të popujve të Ballkanit për ndërtimin e shteteve nacionale.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:

- të vlerësoj fuqinë ushtarake dhe ekonomike të Shtetit osman si njërin prej faktorëve dominues për shtrirjen e pushtetit;
- të qartësoj pikëpamjen për popullimin turk në Ballkan dhe për islamizimin e disa popujve ballkanik;
- t'i kuptoj faktorët e ndryshëm që kanë ndikuar në formësimin e kulturës, artit, arkitekturës në Ballkan,
- të arsyetoj ndikimin e turqishtes mbi gjuhët ballkanike si gjuhë e shtetit, e komunikimit zyrtar dhe gjuhë e komunikimit afarist e kulturor dhe/apo fetar;
- të interpretoj krizat ekonomike të Shtetit osman si faktorë revolte të pakicave ndaj shtetit;
- të gjykoj për arsyet e lëvizjeve kombëtare në funksion të zgjimit dhe përforcimit të identitetit kombëtar;
- të argumentoj arsyet e iniciativat për hapjen e shkollave në gjuhët amtare;

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime			0

Punë praktike			0
Përgatitje për test intermediar	2	1	2
Konsultime me mësimdhënësin	0,5	8	4
Puna në terren			0
Testi, punimi i seminarit	6	1	6
Detyrë shtëpie	2	8	16
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja për provimin final	3	3	9
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	4	4
Total			120:25=4,8 5 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, prezantimet e përgatitura nga studentët në grupe 2-3 studentësh, detyrë shtëpie individuale.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%. Vijueshmëria dhe pjesëmarrja aktive 10%; Kollokfiumi 40%; Provimi final 50%.
Literatura primare:	1. Halil Inalxhik (2010). Perandoria Osmane – Periudha klasike 1300-1600. LOGOS-A, Shkup. 2. Barbara Jelavich (1999). Histori e Ballkanit shek. XVIII-XIX. Tiranë. 3. Nehat Krasniqi (2017). Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e rilindjes kombëtare, Instituti Albanologjik, Prishtinë
Literatura shtesë:	1. Nikolay Antov (2017) The Ottoman “Wild West” The Balkan Frontier in the Fifteenth and Sixteenth Centuries. Cambridge University Press 2. François Geogon & Paul Dumont (2018). Osmanlı İmparatorluğu’nda Yaşamak. İletişim, İstanbul. 3. Kemal Karpat (1985). Ottoman Population, 1830–1914: Demographic and Social Characteristics. Middle East Studies Association of North America (MESA) 4. The Ottomans and the Balkans, a discussion of historiography (2002). Fikret Adanır & Suraiya Faroqhi. Brill

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Betejat osmane në Ballkan deri në pushtimin e Stambollit
Java 2:	Gjeografia dhe demografia e Ballkanit në fillim të shekullit XVI
Java 3:	Organizimi i shtetit osman (shekulli XVI – XIX)
Java 4:	Administrata e vilajeteve të Rumelisë dhe administratorët vendorë
Java 5:	Ekonomia dhe kultura osmane në shekujt XVI-XVII
Java 6:	Popullimi i turqve në Ballkan dhe procesi i islamizimit
Java 7:	Statusi i gjuhës turke në Ballkan (shekulli XIX)
Java 8:	Të krishterët nën sundimin osman
Java 9:	Popujt nën sundimin osman dhe rajonet autonome
Java 10:	Luftërat Osmano-Habsburge dhe popujt e Ballkanit nën sundimin e Habsburgëve
Java 11:	Kryengritjet e para kombëtare në Ballkan (fillimi i shekullit XIX)
Java 12:	Krijimi i shteteve të para kombëtare dhe reformat osmane
Java 13:	Filli i nacionalizmit të popujve të Ballkanit
Java 14:	Shkollat myslimane në Ballkanin perëndimor gjysmën e dytë të shekullit XIX, identiteti osman/turk para luftërave ballkanike
Java 15:	Luftërat ballkanike, identiteti shqiptar dhe pavarësimi i Shqipërisë

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Materialet mësimore duhet të mirëmbahen. Komunikimi i studentëve me mësimdhënësin duhet të përqendrohet në arritjen e qëllimeve të lëndës. Ky komunikim në sallë të mësimi ose në kabinetin e mësimdhënësit (gjatë konsultimeve) duhet të jetë transparent dhe në kuadër të mirësjelljes. Po ashtu edhe komunikimi përmes e-mailit apo edhe kanaleve/mjeteve tjera që i mundësin TI-ja, duhet të jetë në funksion të zhvillimit akademik.

Mjetet e komunikimit, gjatë orës mësimore duhet të mos përdorën për qëllime që nuk përkasin me qëllimet e lëndës. Ndërsa mjetet e njëjta mund të përdorën për realizimin e lëndës mësimore, por duke mos e cenuar privatësinë e askujt në sallën e mësimi.